

PROVIMI PËRFUNDIMTAR NË FUND TË ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT FILLOR

Viti shkollor 2013/2014

TESTI GJUHË SHQIPE

UDHËZIM PËR PUNË

- Testi përmban **20** detyra të cilat duhet t'i zgjidhësh për **120** minuta.
- Secilën detyrë lexoje me kujdes, mendo mirë se çfarë kërkohet në detyrë dhe për mënyrën sipas së cilës duhet ta zgjidhësh (duke e rrethuar, bashkuar, nënvizuar, plotësuar e të tjera).
- Shkruaj shkronjat qartë, duke pasur parasysh që përgjigjet e tua të jenë të kuptueshme, por edhe të sakta në kuptimin gramatikor dhe drejtshkrimor.
- Me rastin e zgjidhjes së detyrave në të cilat prej teje pritet që të plotësosh ndonjë gjë, gjithnjë duhet t'i përdorësh emërtimet e plota; shkurtesat nuk lejohen (psh., duhet të shkruhen emrat, e jo em. ose kallëzorja e jo kall., dhe të ngjashme).
- Plotësoje testin me **stilolaps** (gjatë zgjidhjes së detyrës duhet të përdorësh lapsin e thjeshtë dhe gomën).
- Përgjigjeve të shkruara me stilolaps nuk mund t'u biesh vizë ose t'i korrigjosh.
- Përgjigjja e cila është shkruar vetëm me laps të thjeshtë nuk do të pranohet.
- Në katrorin i cili gjendet në anën e djathtë të detyrës mos shkruaj asgjë. Kjo është hapësirë në të cilën kontrolluesi do t'i shënojë pikat. Në këtë dhe në faqen e fundit gjithashtu nuk mund të shkruash asgjë.
- Nëse e mbaron më herët, dorëzoje testin dhe ngadalë dil jashtë që të mos e pengosh punën e të tjerëve.

Të dëshirojmë sukses në punë!

- 1.** Në tekstin e shkruar më poshtë rretho diftongjet duke i nënvizuar fjalët tek të cilat ndodhen ato dhe shkruaji me rradhë këto diftongje mbi vizën që kemi shënuar më poshtë:

Genci tek sa po i biente fyellit, re të zeza filluan të mbulonin qiellin. Mblodhi delet dhe u kthye para se të fillonte të binte shi.

- 2.** Vepra apo teksti të cilin e shkruan një autor, përveç tjerash mundet të përmbajë edhe një përshkrim shtesë ose informativ gjatë të shkruarit ku për të sqaruar më mirë ndonjë shprehje të shprehur me fjalë, fjali apo edhe me një paragraf të tërë e që zakonisht shënohet me numër të vogël me kllapë ose me yll prapa quhet:

- a) Fusnotë;
- b) Kapitull;
- c) Nëntitull;
- d) Përmbajtje.

- 3.** Shkruaj mbi vizat që janë shënuar poshtë se cila nga këto fjali është fjali dëftore dhe cila është fjali dëshirore.

- 1. A do të garojë klasa jonë në këtë olimpiadë?
- 2. Mësuesi zgjodhi dy nxënës përfaqësues, një vajzë dhe një djalë.
- 3. A do të arrijmë të marrim ndonjë vend të parë?
- 4. Urojmë që klasa jonë t'ia dali mbanë.

1. _____

2. _____

4. Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë. Çfarë tregon mënyra lidhore:

- a) Një veprim real
- b) Një veprim të mundshëm a të dëshiruar
- c) Një veprim të papritur
- d) Një veprim të kushtëzuar nga një veprim tjetër.

5. Tana
Dëgjo, burrë...

Vangjeli
Ç'ke, moj grua?
T. (Rënkon.)
Jam sëmure.

V.
Që kur! Ç'thua?

T.
Ç'them? Ja them që jam sëmure,
koka më digjet si furrë,
së keshë pësuar kurrë.

V.
Po tani, vallë, ç'pësove?
Më duket se u ftove;
gjithë natën u zbulove
dhe s'më lë fare të flërë!

T.
Gjithë ditën ç'keshe bërë?
Ti për bar e për dru s'vete
dhe qahesh se nukë flete?
Tërë ditën ngas qetë
dhe drek' e darkë bëj vetë,
gjithë puna përmi mua!

V.
Përse të kam marrë grua?
Gratë për punë po janë.

T. (Qesëndis.)
Edhe burratë të hanë
dhe të rrinë nat' e ditë!

Cilës gjinie letrare i takojnë vargjet e mësipërme të autorit Anton Zako Çajupi. Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë:

- a) epike
- b) lirike
- c) dramatike

6. Trego llojin e tekstit me të cilin është shkruar teksti i mëposhtëm:

Ishte një qytezë me tulla të kuqe, ose që do të ishin të kuqe nëse tymi dhe hiri do t'i linte, po ja që ashtu janë sjellë punët që ajo u bë një qytezë me të kuqe e të zezë të panatyrshme, si fytyra e ngjyrosur e një njeriu të egër.

Teksti i shkruar i përket llojit:

- a) argumentues
- b) biografik
- c) përshkrues
- d) autobiografik

7. Fjalitë e shkruara më poshtë do t'i shkruajmë në dy variante atë drejtshkrimore dhe jodrejtshkrimore. Rretho shkronjën përpara fjalive të shkruara drejt:

- a) Noriku dhe Luani po shikonin në vitrinën e një dyqani që shiste biçikleta.
- b) Noriku dhe Luani në vitrinën e një dyqani po shikonin që shiste biçikleta.
- c) Mjeku po e këshillonte Anën se si duhej ti merrte ilaçet.
- d) Mjeku se si duhej Anën ti merrte ilaçet po e këshillonte.

8. Duke rrethuar shkronjën a) ose b) trego se cili nga tekstet e shkruara nuk i përket tekstit letrar:

a) Pema është një nga elementet më përfaqësuese të natyrës. Në veprat e piktorit Vinsent Van Gog (1853-1890) mund të shohësh pemë nga më të ndryshmet. Në një letër ai i shkruan vëllait: “ Jam në vrullin e punës, sepse pemët janë të gjitha në lulëzim dhe e gjitha kjo është një gëzim i pabesueshëm”. Në këtë vrull krijues ai realizoi shtatë piktura pemësh në lulëzim.

b) Pemët tanimë kishin filluar të lulëzonin.

Pranvera ende nuk kishte ardhur, por moti po mbante nxehtë dhe diell kishte sikur në mes të pranverës.

Djaloshi u ngrit nga shtrati dhe vrapoi drejt dritares për të parë trumcakët e vegjël që po cicërrinin në degët e pemëve pranë shtëpisë së tij. Ai po vështronte natyrën dhe po i gëzohej blerimit dhe lulëzimit të pemëve.

9. Stilit politiko-shoqëror i takojnë:

- a) Vërtetime, kërkesa
- b) Recensione, kritika
- c) Fjalime, raporte
- d) Reportazhe, përshkrime udhëtimi

10. Mbi vizat e zbrazëta duhet të shkruash informacionet e nevojshme për t'i dërguar një ftesë shokut ose shoqes që do ta ftosh për ditëlindjen tënde. Përpiqu që të japësh informacionin e duhur duke përdorur pyetjet: për kë? çka, kur, ku, kush?:

FTESË

Për: _____

Ju _____ që të _____ më _____, _____
në _____.

Me respekt:

Kush _____

11. dikush më solli një ftesë në ftesë shkruhej se krejt ishim ftue për ditë lindjen e Arianit, deri at dit askush nuk dinte se ariani do ta festoje ditëlindjen në klasë. Ne njoftuam njëri-tjetrin Askush s'mbeti pa lajmërue se cilit nga ne u ngarkua me nga një detyrë.

Teksti i shkruar këtu është dhënë në variantin e gabuar drejtshkrimor, ju duhet ta rishkruani por kujdes, në variantin e saktë drejtshkrimor.

- 12.** Fjalët e shkruara më poshtë duhet radhitur nga shkronja a) e deri tek shkronja d) vetëm ato fjalë që janë pjesë të pandryshueshme të ligjëratës, trego cilat janë ato:

Shkoj, vij; në, për; dru, krah; jo, po; i butë, i trashë; eh, uh; shtatë, i dyti edhe, sapo; ai, ata; atje, poshtë;

a) _____

b) _____

c) _____

ç) _____

d) _____

- 13.** Fjalja e dhënë përbëhet nga disa gjymtyrë kryesore dhe të dyta. Nënvizoj kryefjalën dhe kallëzuesin dhe trego se me çfarë pjesë të ligjëratës janë shprehur.

Makina jonë iu afrua fundit të garës.

- 14.** Në dialogun që po zhvillohet poshtë Ana po flet pa fakte dhe pa argumente për Mirelën, në këtë rast rretho shkronjën përpara, dhe trego se cilën prej mundësive të dhëna po e përdor Ana:

Ana: Ty Mirela mundem të të them se je shumë xheloze dhe tepër naive. Ti moj vajzë as që i kupton gjërat që po ndodhin rreth teje e lëre më të përkushtohesh e t'i ndjekësh hapat e modës.

Mirela: Më fal Ana më duket se nuk je duke folur drejt dhe nuk po i gjykon gjërat si duhet. Po flet pa argumente dhe fakte prandaj dyshoj se dikush mund t'i besojë kësaj që po thua për mua.

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë:

a) objektivitetin,

b) paragjykimin,

c) propagandën.

15. Përshkruaj një ndeshje emocionuese sikur je duke raportuar drejtpërdrejt nga stadiumi.

Vendos në tekstin e mëposhtëm fjalët përkatëse që e përshkruajnë këtë raportim. (Kujdes! Fjalët janë të përziera):

(miq, ndeshjen, takohemi, midis, fundit, kjo, merr, sezon, pasim, sulmuesi, pason, portës, gjuan, goooooo!!!! skuadrën, këtë, kampion, mrekullueshëm,).

Mirëdita të nderuar _____, ja ku po _____, për të përcjellë _____ e futbollit _____ Flamurtarit dhe Teutës. Është _____, ndeshja e _____ për këtë _____. Topin e _____ skuadra e Flamurtarit që niset në sulm, një _____ i bukur tek _____ i krahut të majtë ai _____ tek qendër sulmuesi, i cili _____ në drejtim të _____ dhe _____. 1 me 0 për _____ e Flamurtarit. Dhe me _____ gol të _____ të nderuar miq, Flamurtari shpallet _____ i super ligës për këtë sezon.

16. Rretho fjalët që janë pjesë të ndryshueshme të ligjëratës.

Tavolinë, me , të, ajo, në, flas, por, i vjetër, o bobo, mos, edhe, i lartë, hej,

17. Bagëti e Bujqësi – Naim Frashëri

O malet' e Shqipërisë e ju o lisat' e gjatë!
Fushat e gjëra me lule, q'u kam ndër mënt dit' e natë!
Ju bregore bukuroshe e ju lumenjt' e kulluar!
Çuka, kodra, brinja, gërxhe dhe pylle të gjelbëruar!
Do të këndonj bagëtinë që mbani ju e ushqeni,
O vendëthit e bekuar, ju mëndjen ma dëfreni.

Përpara përgjigjes së saktë rretho shkronjën përkatëse se:

Vargjet e shkëputura nga Bagëti e Bujqësi të Naim Frashërit cilës periudhe të letërsisë i takojnë:

a) Nuk i takojnë periudhës së Rilindjes Kombëtare.

b) I takojnë periudhës së Rilindjes Kombëtare.

18. Pranë titullit të çdo vepre letrare (në vizë), shkruaj numrin përkatës, i cili gjendet para emrit dhe mbiemrit të shkrimtarit që e ka shkruar veprën:

___ “Kronikë në gurë”

___ “Gjahu i malësorëve”

___ “Kroi i fshatit tonë”

1. Lasgush Poradeci

2. Migjeni

3. Sabri Hamiti

4. Ismail Kadare

5. Çajupi

6. Konstantin Kristoforidhi

19. Trego kuptimin e fjalës së nënvizuar në fjalinë e dhënë

Mos na shitë mend – i tha Agroni – se ta dimë forcën dhe trimërinë.

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë

- a) Iu është rritur mendja
- b) Është mendjemadh e mburret para të tjerëve
- c) Është i sëmurë dhe i dhemb koka

20. Lexo me kujdes vargjet e mëposhtme:

“O, si nuk kam një grusht të fortë
T’ bij mu në zemër malit që s’bëzanë
Ta dij dhe ai se Ç’domethënë i dobët,
N’agoni të përdridhet si vigan i vramë”

Cila figurë është përdorur në këto vargje.
